



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA EKONOMIKE  
PROJEKT - VENDIM**

**Nr. 17 Datë 23/08/2024**

**“Për Përdorimin e Fondit të akorduar nga Emergjencat Civile, për objektin “Ndërtim i urës së përroit të Kusarëve, Fshati Katund i Ri, Njësia Administrative Luzni”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, VKM 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” dhe VKM nr 414 date 08/07/2021 “Per miratimin e kriterëve dhe procedurave te ndarjes dhe perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile” pika3.1 germa b,c,gj kërkojmë që fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret si më poshtë:

**Kërkojmë:**

- I. Nga fondi i akorduar nga Emergjencat Civile të përdoret për nderhyrjen ne objekt “Ndërtim i urës së përroit të Kusarëve, Fshati Katund i Ri, Njësia Administrative Luzni” me vlerë financimi 1.263.635 (një milion e dyqind e gjashtedhete e tre mije e gjashtëqind e tridhete e pese) lëkë:
- II. Te perdoret fondi emergjencave civile programi 10910 në vlerën **1.263.635** .Përdorimi i shumes perkatese do te behet ne artikullin 604 programi 10910 e miratuar me shkresen nr.3806/1 prot date 29.03.2024 te Ministrise Financave
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e PPECK, Drejtorja e Shërbimeve, Sektori i Prokurimeve Publike dhe Drejtorja Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**PËR BASHKINË DIBËR:**

Drejtor Juridik  
Ismet Saraçi

Drejtor PPECK  
Hazbi Kamberi

Drejtor Shërbimeve Publike  
Bedri Kamberi

Drejtor Ekonomik  
Çeljeta Zuna

**KRYETARI I BASHKISË**

Rahim Spahiu  
Në mungesë dhe me përosi  
Zv. Kryetar  
Ruzhdi Deda



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA E SHERBIMEVE**

Peshkopi, më 23 / 09 / 2024

Lenda: Dërgim informacioni.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak, Bashki Dibër.

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në kërkesat e vazhdueshme të banorëve të fshatit Katund i Ri, si dhe të Njesisë Administrative Luzni, lidhur me ndërtimin e një ure të re në përroin e quajtur Kusare, fshati Katund i ri, ju informojmë si më poshtë:

Përroi i mësipërm ka qenë dhe është problematik edhe sot, sidomos për kalimin e këmbësorëve të zonës, për sa i përket prurjeve të tijë, sidomos gjatë periudhës së vjeshtës, dimrit dhe pranverës.

Theksojmë se më parë dhe aktualisht automjetet dhe këmbësoret kalojnë në rrjedhjen e tijë, pa një ure kalimi, e cila është e domosdoshme për nxënësit e shkollës në radhë të parë, këmbësoret dhe për automjetet.

Ju bejme medije gjithashtu se në këtë urë e cila është e domosdoshme dhe mendohet të ndëtohet, kalojnë mbi 200 banorë, kryesisht banorë të jashtëm dhe vendas,

Konkretisht lagja: Mere ka 11 shtëpi, Poliçe 6 shtëpi, Dede 6 shtëpi, Drnova 6 shtëpi si dhe lagja Late 15 shtëpi.

Kjo urë është e domosdoshme , pasi në lagjen Drnova shpesh herë ka patur edhe përmbytje, duke ju hyrë ujë edhe në oborrin e shtëpive.

Theksojme se nga verifikimi dhe matjet në vend, si dhe bazuar në kërkesën e banorëve dhe të Njesise Administrative, meqenëse këtu përveç kembësorëve të zonës dhe të tjerë, kalojnë edhe

automjete të tonazhit të rënde që vijnë me inerte nga fshati Muhurr, është e domosdoshme që të ndërtohet një urë betoni një kalimshe me hapsirë drite tre ml.

Ju informojmë gjithashtu para se të vazhdojnë punimet për ndërtimin e urës, të bëhet me parë sistemimi i shtratit të përroit, duke e gërmuar atë, pasi gjatë viteve ka krijuar mbushje duke dalë nga shtrati i tijë dhe duke bërë përmbytje në lagjen e fisit Drnove.

Ju bejmë medije gjithashtu, se nga matjet dhe përlllogaritjet e bëra vlera e preventivit të punime në urën e mesipërme rezulton **1 053 029** lek të reja pa tvsh dhe **1 263 634** lek me tvsh.

Bashkëngjitur këtijë informacioni keni preventivin e hartuar nga ana jonë.

Faleminderit për bashkëpunimin,

Hartoi  
Bedri Shehu  
Ermal Xhaka



Drejtori i Drejtorisë Shërbimeve


Bedri Kamberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

MIRATOHET  
ZV/KRYETARI  
RUZHDI DEDA



**PREVENTIV**  
**OBJEKTI:NDERTIM URE B/A HD=3M, PERROI KUSARES**  
**FSHATI : KATUND I RI. NJ. ADMINISTRATIVE LUZNI.**  
**VITI NDERTIMIT 2024**

NR.	NR.AN.	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	CMIMI	VLEFTA
1	3.87/a	Germim dheu me eskavator me goma0.35m3,kat III,shkarki. ne toke	m3	21.4	1338.31	28,639.83
2	3,243	Ndertim mure betoni themel+lartesi C-16/20	m3	24.3	14862.33	361,154.62
3	3,247	Ndertim jastek beton/arme C 25/30	m3	2.25	14324.26	32,229.59
4	3,247	Strukture monolite betoni me çakull C-16/20	m3	4.4	15719.72	69,166.77
5	3,195	Hidroizolim me dy duar bitum M-5 mbi soleten beton/arme.	m3	18	634.48	11,420.64
6	2.264/2	Shtrese betoni mbi hidroizolim C-16/20, me trashesi = 8cm.	m3	1.4	964.32	1,350.05
7	3,289	F.V hekur periodik me diameter > 12 mm	ton	0.85	127686.5	108,533.52
8	2.110/2	Themel + xokol buto/betoni C-12/15 me 20% gure	m3	14.5	13070.00	189,515.00
9	2.264/1	Shtrese betoni C- 16/20, t= 15 cm	m3	4.6	13857.42	63,744.13
10	3.47/1b	Mbushje dhe ngjeshje me zhavorr lumi çdo 30 cm me makineri	m3	84	1864.34	156,604.56
		<b>SHUMA :</b>				<b>1022359</b>
		<b>Fond rezerve 3%</b>				<b>30,670.00</b>
		<b>Shuma:</b>				<b>1 053 029</b>
		<b>T.V.SH 20 %</b>				<b>210 605,8</b>
		<b>SHUMA TOTALE</b>				<b>1 263 634,8</b>

**Shënim: Çmimet në preventiv, janë marrë bazuar në manualin e preventivimit.**

**PREVENTIVOI:**

**ING. BEDRI SHEHU**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT  
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhurj është adresuar Bashkisë Dibër nga MINISTRI I FINANCAVE dhe mban nga dërguesi nr 3806  
date 29.03.2024 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr hyres prot 1266  
04.04.2024

Praktika u drejtohet për administrim:

Znj/Z PROSTOMA ECONOMIKE

Znj/Z  
Znj/Z A.P. G. A. K.

me porosinë

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 04.04.2024

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

1266 04/04/24

Nr. 3806 / 1 Prot.

Tiranë, më 29.03.2024

Lënda: Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile, për vitin 2024.

BASHKISË DIBËR  
DEGËS SË THESARIT —  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

Për dijeni: **MINISTRISË SË MBROJTJES**  
*Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë*

Në zbatim të pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pikës 16, të Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", si dhe mbështetur në shkresën e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 1730 Prot., datë 20.03.2024, nëpërmjet të cilës është paraqitur kërkesa për shpërndarjen e fondit të kushtëzuar në programin "Emergjencat Civile", për njësi të vetëqeverisjes vendore, miratojmë shpërndarjen e këtij fondi tek 61 bashkitë, sipas tabelës bashkëlidhur, në lekë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM




Tabela e ndarjes së fondit të kushtëzuar për vitin 2024 në shpenzime korente në programin "Emergjencat Civile" sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

E.Q	M.L	Kod Institucioni	Emeritim Institucioni	Kap.	Progr.	Llog. Ekon.	Kod D. Thesarit	në lekë		Totali
								kod Produkti	kod Produkti	
Shtohet										
106	17	2106001	Bashkia Dibër	01	10910	6040000	0606	91707AG	91707AB	10,109,504
								4,403,800	5,705,704	

Kod produkti	Emërtim Produkti
91707AB	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cileve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.
91707AG	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve